

VENDIM
Nr. 268, datë 11.10.2022

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KOMUNIKIMIN E
KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË ME MEDIAN”**

Bazuar në nenin 189, pika 1, germa “c”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar; në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; në ligjin nr. 7756, datë 11.10.1993, “Për shtypin”, të ndryshuar; në ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; në ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”; në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, të ndryshuar; në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar; rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, si dhe me propozimin e grupit të punës ngritur me urdhrin e kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 132, datë 14.9.2022, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për komunikimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë me Median”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare *web* të Këshillit.
3. U shpall në Tiranë, sot, më 11.10.2022.

KRYETAR
Alfred Balla

RREGULLORE
PËR KOMUNIKIMIN E KËSHILLIT TË LARTË TË
PROKURORISË ME MEDIAN

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

1. Kjo rregullore përcakton parime, rregulla dhe procedura të veçanta, pjesë e rregullave për marrëdhëniet me publikun të Këshillit, komunikimin e ligjshëm, transparent, të përgjegjshëm dhe profesional të Këshillit me median e shkruar dhe elektronike, si dhe me çdo përfaqësues të saj.
2. Në bazë të dispozitave të kësaj rregulloreje, duke synuar krijimin e lehtësirave për qasjen ndaj informacionit nga përfaqësuesit e mediave, do të ndërtohet dhe do të vihet në funksionim një rubrikë e veçantë në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.
3. Komunikimi, në kuptimin e kësaj rregulloreje, përfshin të gjitha mënyrat e vendosjes së kontakteve institucionale ndërmjet Këshillit dhe medias, si dhe shkëmbimin e informacionit në formë të shkruar, audio, video apo të dhëna.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Këshilli” është Këshilli i Lartë i Prokurorisë.
- b) “Kodi i Etikës së Gazetarit” është instrumenti vetërregullues i normave të etikës së gazetarëve, si dhe standardet ndërkombëtare në këtë fushë.
- c) “Anëtari i caktuar i Këshillit” është anëtari i caktuar për kryerjen e detyrave, në lidhje me marrëdhëniet me publikun, me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
- ç) “Koordinatori për të Drejtën e Informimit” është nëpunësi i caktuar i Këshillit, në zbatim të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”.
- d) “Njësia mbështetëse” është njësia përgjegjëse për marrëdhëniet me publikun dhe botimet e Këshillit, e cila përbush detyrimet e kësaj rregulloreje për komunikimin me median.

Neni 3 **Kuadri ligjor**

Kjo rregullore zbatohet në përputhje me:

- a) ligjin nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar;
- b) ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- c) ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”;
- ç) ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar;
- d) rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, miratuar me vendimin nr. 407, datë 17.12.2021.

Neni 4 **Fusha e veprimit**

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen në sferën e komunikimit me median dhe publikun, me qëllim garantimin e pasqyrimin të qëndrimit institucional të Këshillit në funksion të transparencës në komunikimin me median dhe publikun.

2. Detyrat për komunikimin me median realizohen nga anëtari i caktuar i Këshillit, i cili asistohet nga njësia mbështetëse. Njësia mbështetëse përbëhet nga Këshilltari për marrëdhëniet me median dhe Koordinatori për të Drejtën e Informimit. Kjo njësi, nën mbikëqyrjen e anëtarit të caktuar të Këshillit, organizon punën brenda institucionit, me qëllim vlerësimin, përgatitjen dhe redaktimin e një informacioni përmbledhës e të qartë, i cili garanton qëndrimin transparent, profesional dhe institucional të Këshillit, në raport me median dhe publikun.

Neni 5 **Parimet e komunikimit me median**

Përveç sa parashikohet në nenin 91, pika 5, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, parimet e së drejtës së aksesit të mediave në informacion janë:

- a) parimi i objektivitetit, llogaridhënies, profesionalizmit, besueshmërisë, ndershmërisë dhe mirëbesimit, të raportimit korrekt të lajmit;
- b) parimi i prezantimit të saktë të informacionit, që nënkupton shmangien e deformimit dhe të keqinterpretimit dhe ndalimin e shpërdorimit të informacionit për komente dhe opinione, që bien ndesh me vlerat e drejtësisë dhe të një shoqërie demokratike apo që nuk kanë lidhje me vlerat e shtetit të së drejtës;
- c) parimi i respektimit të pavarësisë së prokurorisë dhe i mosndërhyrjes në funksionin e saj;
- ç) parimi i respektimit të solemnitetit të procedurave dhe i autoritetit të drejtësisë;

- d) parimi i respektimit të të drejtave themelore të njeriut dhe i respektimit të mbrojtjes së të dhënave personale;
- dh) parimi i mbrojtjes së sekretit shtetëror dhe i sigurisë kombëtare;
- e) parimi i respektimit të efektivitetit të politikave qeverisëse dhe i mosrrezikimit të funksioneve të gjyqësorit;
- ë) parimi i mbrojtjes së kategorive të veçanta, si të miturit dhe viktimat, nga veprat penale;
- f) parimi i respektimit të dinjitetit të prokurorëve;
- g) parimi i moscenimit të efektivitetit të luftës ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar, i mbrojtjes dhe i mosdekonspirimit të dëshmitarëve, si dhe të çdo informacioni konfidencial të administruar nga organet e sistemit të prokurorisë dhe nga Këshilli;
- gj) parimi i transparencës;
- h) parimi i ligjshmërisë;
- i) parimi i respektimit të etikës;
- j) parimi i respektimit të shtetit të së drejtës;
- k) parimi i mirëkuptimit dhe i bashkëpunimit, në funksion të harmonizimit të vlerave të rolit të lirisë së shtypit dhe drejtësisë, si përbërës thelbësorë të një shoqërie të lirë dhe demokratike.

KREU II KOMUNIKIMI ME MEDIAN

Neni 6 Përfaqësimi me median

1. Kontaktet e Këshillit me përfaqësuesit e medias do të mbahen nga Koordinatori për të Drejtën e Informimit, vetëm sipas udhëzimeve dhe nën mbikëqyrjen e anëtarit të caktuar nga Këshilli, i cili miraton paraprakisht çdo informacion që i përcillet medias.
2. Vendosja e kontaktit dhe komunikimi i mëtejshëm me median realizohet nëpërmjet një adrese të posaçme të postës elektronike (*e-mail*): info@klp.al, e cila përdoret nga Koordinatori për të Drejtën e Informimit.
3. Në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë caktohet një rubrikë e veçantë me emërtimin “Kontakti me median”.
4. Gazetarët mund të paraqesin kërkesën e tyre edhe nëpërmjet një formulari, sipas modelit të lidhjes 1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje. Informacioni që duhet të plotësohet në këtë formular nga gazetari lidhet me të dhënat personale, institucionin që përfaqëson, qëllimin dhe përmbajtjen e shkurtër të problematikës. Formulari i kontaktit vendoset në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
5. Për çështje që kanë të bëjnë me përmbushjen e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, me objektiva të rëndësishëm të politikave qeverisëse dhe funksionet e Këshillit, të mbarëvajtjes së reformës në drejtësi, ngjarje me rëndësi kombëtare dhe me rëndësi për të gjithë sistemin e drejtësisë ose për çështje të tjera që kanë të bëjnë me anëtarët e këtij Këshilli, komunikimi me median mund të realizohet drejtpërsëdrejti nga kryetari. Në rastet kur përfaqësimi në media lidhet me qëndrime të Këshillit, komunikimi duhet të kryhet vetëm pas konsultimeve paraprake me Këshillin.

Neni 7 Trajtimi i kërkesave

1. Anëtari i caktuar i Këshillit mbikëqyr të gjithë procedurën e brendshme të pranimit dhe trajtimit të kërkesave, dhe mbajtjes së kontakteve me median, duke informuar në mënyrë të vazhdueshme Këshillin dhe kryetarin e tij.

2. Anëtari i caktuar i Këshillit jep miratimin për fillimin e procedurës së brendshme, e cila koordinohet nga Koordinatori për të Drejtën e Informimit, për realizimin e kontaktit me median për kërkesën e paraqitur.

3. Këshilli trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj. Ky afat mund të zgjatet me jo më shumë se 5 ditë pune, kur lind nevoja për të kërkuar dhe shqyrtuar dokumente të shumta e voluminoze, për të shtrirë kërkimet pranë prokurorëve, si dhe kur lind nevoja për t'u konsultuar me autoritete të tjera publike, përpara marrjes së një vendimi për plotësimin ose jo të kërkesës.

4. Kërkesa për informim mund të refuzohet nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj:

a) sigurisë kombëtare, sipas përkufizimit të bërë nga legjislacioni për informacionin e klasifikuar;

b) parandalimit, hetimit dhe ndjekjes së veprave penale;

c) mbarëvajtjes së hetimit administrativ në kuadër të një procedimi disiplinor;

ç) mbarëvajtjes së procedurave të inspektimit dhe auditimit;

d) këshillimit dhe diskutimit brenda Këshillit.

5. Kërkesa për informim mund të refuzohet edhe kur:

a) nuk është shprehur qartë ose është haptazi abuzive;

b) për informacionin e kërkuar ekziston tashmë material i publikuar prej Këshillit;

c) për informacionin e kërkuar i është dhënë informacion i mëparshëm të njëjtit kërkues;

ç) çështja për të cilën kërkohet informacion është ende në proces, e papërfunduar.

6. Në rast të refuzimit, kërkuesit i komunikohet shkak i refuzimit në mënyrë të arsyetuar.

Neni 8

Lehtësitë për aksesin në informacion nga media

1. Këshilli zhvillon dhe mirëmban një portal elektronik në internet, me qëllim ofrimin e informacionit të duhur për çështjet me interes publik. Këshilli, vë në dispozicion një rubrikë në faqen e tij zyrtare në internet me informacion të përditësuar, që i adresohet medias, si një kategori e specializuar dhe profesionale e komunikimit të Këshillit me publikun. Rubrika hartohet e tillë, që të sigurojë informacion të paanshëm, objektiv dhe profesional, të lehtësojë vështirësitë e detyrës për median, duke i përcjellë publikut një informacion të besueshëm, lehtësisht të perceptueshëm, në lidhje me sistemin e drejtësisë, politikat dhe funksionet e Këshillit.

2. Mediat kanë të drejtë të kenë një përfaqësues të akredituar pranë Këshillit, i cili nënshkruan një deklaratë, sipas së cilës angazhohet për trajtimin e informacionit të marrë nga Këshilli, në përputhje me kërkesat profesionale dhe parimet e kësaj rregulloreje. Akreditimi i mediave të huaja bëhet pas akreditimit të tyre nga Ministria e Jashtme, sipas vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave.

3. Çdo kërkesë për informacion duhet t'i drejtohet Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, i cili është përgjegjës edhe për koordinimin e sigurimit të informacionit brenda institucionit. Koordinatori për të Drejtën e Informimit, me miratimin e anëtarit të caktuar të Këshillit, ka të drejtë të kërkojë nga drejtuesi përkatës i medias së akredituar zëvendësimin e një gazetari, nëse rezultojnë shkelje qartësisht të dallueshme të objektivitetit dhe profesionalizmit, si dhe për shkelje të Kushtetutës, ligjit, dhe të parimeve të kësaj rregulloreje.

4. Në rastin kur shkelja është publike, e rëndë apo flagrante, anëtari i caktuar nga Këshilli merr vendim për heqjen e akreditimit të gazetarit që kryen shkeljen. Vendimi i komunikohet drejtuesit të medias përkatëse, nëpërmjet Koordinatorit për të Drejtën e Informimit. Në këtë rast, anëtari i caktuar njofton Këshillin në mbledhjen e radhës.

5. Kërkesat për informacion do të dërgohen si rregull përmes postës elektronike, si edhe përmes telefonit, gjatë ditëve të javës, nga ora 08:00 deri në 16:00, e në raste të veçanta të karakterit të ngutshëm edhe jashtë këtij orari. Çdo kërkesë regjistrohet në protokoll dhe merr një numër të veçantë.

Neni 9

E drejta e akreditimit

Të drejtën e akreditimit e gëzojnë të gjitha mediat audiovizive, të shkruara dhe elektronike, shqiptare dhe të huaja, si dhe punonjësit e medias në profesion të lirë.

Neni 10

Personat e akredituar

Akreditimi jepet, për:

- a) gazetarë;
- b) fotografë (fotoreporterë);
- c) ekiye xhirimi;
- ç) teknikë;
- d) operatorë;
- dh) regjisorë;
- e) kameramanë.

Neni 11

Kohëzgjatja e akreditimit

Akreditimi pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë mund të jetë;

- a) ditor;
- b) javor;
- c) mujor;
- ç) vjetor (vit kalendarik).

Neni 12

Pajisja me kartë akreditimi

1. Dokumentacioni i paraqitur shqyrtohet nga anëtari i caktuar për mediat, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga paraqitja.

2. Në rast përmbushjeje të kriterëve dhe dokumentacionit, personat pajisen me kartën e akreditimit të lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Karta e akreditimit, kur kërkohet nga institucioni mediatik, përmban: emër/mbiemër; institucionin mediatik, që përfaqëson periudhën e akreditimit, funksionin që mban personi, fotografi në përmasat 4x3, numrin rendor.

4. Karta e akreditimit për punonjësit e medias në profesion të lirë përmban: emër/mbiemër, periudhën e akreditimit, fotografi në përmasat 4x3, numrin rendor.

5. Personat e akredituar gjatë qëndrimit (gazetarë dhe operatorë) në Këshill duhet të mbajnë në vend të dukshëm dokumentin identifikues me emrin e medias nga e cila vijnë.

Neni 13

Rinovimi i kartës së akreditimit

Karta e akreditimit rinovohet me kërkesë të institucionit mediatik ose të vetë punonjësit të medias në profesion të lirë.

Neni 14
Regjistri elektronik

1. Koordinatorin për të Drejtën e Informimit krijon regjistrin elektronik për personat e akredituar.
2. Regjistri elektronik përmban:
 - a) listën e mediave audiovizive, të shkruara dhe elektronike, të akredituara në Këshillin e Lartë të Prokurorisë;
 - b) përfaqësuesit e tyre;
 - c) kohën e akreditimit;
 - ç) kontakte të nevojshme.

KREU IV
BASHKËVEPRIMI ME MEDIAN

Neni 15
Shoqërimi

Punonjësit përgjegjës për rendin dhe sigurinë e Këshillit, si dhe kur shihet e nevojshme, edhe përfaqësues nga zyra e shtypit, sigurojnë shoqërimin e personave të akredituar gjatë qëndrimit të tyre në ambientet e Këshillit.

Neni 16
Aktivitetet informuese

1. Këshilli komunikon në mënyrë proaktive me median dhe organizon aktivitete të përbashkëta me median dhe organizatat partnere, në lidhje me veprimtarinë e sistemit të prokurorisë.
2. Këshilli përgatit dhe shpërndan njoftime për shtyp, planifikon konferenca për shtyp dhe organizime të veçanta për median, si dhe mban një arkiv me artikuj nga media rreth sistemit të prokurorisë dhe Këshillit.
3. Këshilli krijon dhe shpërndan materiale informative dhe edukative për publikun përmes kanaleve të duhura të komunikimit, që përfshijnë ndër të tjera faqen zyrtare të internetit, median e shtypur, median elektronike dhe rrjetet sociale.

Neni 17
Paraqitja në mbledhje plenare

Personat e akredituar pranë Këshillit, gjatë zhvillimit të mbledhjeve plenare, paraqiten me veshje etike dhe përdorimi i telefonave celular duhet bërë pas aktivizimit të gjendjes “*silent*”.

Neni 18
Organizimi i intervistave

1. Organizimi i intervistave me anëtarët e Këshillit zhvillohet në bazë të kërkesës së paraqitur nga personat e akredituar, në adresën elektronike (*e-mail*): info@klp.al.
2. Kërkesa përmban:
 - a) emër/mbiemër të personit që do të intervistohet;
 - b) çështjet konkrete për të cilat kërkohet intervista.
3. Intervista zhvillohet në datën dhe orën e caktuar nga personi intervistuar në një nga mjediset e mëposhtme:
 - a) në zyrën e anëtarit;

- b) në zyrën e Komisionit të përhershëm ku anëtari bën pjesë.
- c) në ambientet e tjera të përcaktuara nga Këshilli për intervista.

Neni 19

Organizimi i konferencave për shtyp

1. Konferencat për shtyp organizohen në ambientet e caktuara për këtë qëllim. Njoftimi për zhvillimin e konferencës bëhet jo më pak se dy orë nga momenti i mbajtjes së konferencës.
2. Koordinatorin për të Drejtën e Informimit në Këshill, njofton median e akredituar për orën dhe vendin e zhvillimit të konferencës për shtyp.
3. Koordinatorin për të Drejtën e Informimit është përgjegjës për ndjekjen dhe mbarëvajtjen e konferencës.
4. Koordinatorin për të Drejtën e Informimit u vë në dispozicion personave të akredituar një kopje të deklaratës, me kërkesën e tyre.

Neni 20

Pasqyrimi në media i mbledhjeve plenare të Këshillit

1. Në përputhje me nenin 190, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, mbledhjet plenare të Këshillit pasqyrohen në media, duke postuar në faqen zyrtare në internetit edhe një njoftim të shkurtër për shtyp, me përmbledhjen e çështjeve që paraqesin interes për publikun.
2. Përfaqësuesit e medias që dëshirojnë të marrin pjesë në mbledhjen plenare të Këshillit, duhet të paraqesin dokumentin e akreditimit personal dhe të identifikimit të medias që përfaqësojnë. Në rastet e zhvillimit të mbledhjeve në distancë (*on-line*), dokumenti i akreditimit personal mund të dërgohet elektronikisht.
3. Ndalohej regjistrimet audiovizuale të mbledhjeve të Këshillit, pa autorizimin paraprak të tij. Përfaqësuesit e medias që dëshirojnë të bëjnë regjistrime audiovizuale duhet të kërkojnë leje paraprake nga Këshilli, të paktën 4 orë përpara orës së caktuar për mbajtjen e mbledhjes. Koordinatorin për të Drejtën e Informimit u komunikojnë përfaqësuesve të medias kushtet për të cilat jepet leja, e cila mund të kufizohet ose refuzohet për arsye sigurie, ose arsye të tjera madhore.
4. Komunikimi i përfaqësuesve të medias gjatë zhvillimit të mbledhjes duhet të jetë etik dhe profesional dhe në asnjë rast nuk duhet të pengojë sadopak zhvillimin normal të saj. Drejtuesi i mbledhjes së Këshillit mund të kufizojë ose të ndalojë këtë komunikim, nëse ai ndikon në zhvillimin normal të mbledhjes.
5. Seancat dëgjimore për procedimet disiplinore janë publike. Këshilli, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë zhvillimin me dyer të mbyllura, sipas rasteve të parashikuara në ligj.
6. Diskutimet dhe vendimmarrja nga anëtarët e Këshillit në dhomë këshillimi do të kryhen pa praninë e mediave.
7. Përpara fillimit të mbledhjes, anëtari i caktuar i Këshillit udhëzon Koordinatorin për të Drejtën e Informimit, në lidhje me mundësinë e kryerjes së fotografive dhe filmimeve dhe kohëzgjatjen e tyre. Me kalimin e afatit të caktuar, kamerat dhe mikrofonat fiken dhe duhet të largohen me qetësi nga salla ku zhvillohet mbledhja.
8. Në interes të zhvillimit të rregullt të mbledhjes, regjistrimet vizuale lejohen vetëm nga një pozicion i caktuar në sallë, sipas udhëzimeve të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit. Në rastet e interesit të madh të mediave, drejtuesi i mbledhjes mund të kufizojë numrin e ekipeve me kamera, që do të lejohen në sallën e mbledhjeve. Këshilli mund të përcaktojë si kusht për mediat që do të kenë akses, të bashkëpunojnë për t'u shpërndarë regjistrimet mediave të tjera.

9. Këshilli do të monitorojë zbatimin korrekt të rregullave të komunikimit me median dhe merr masat e parashikuara në këtë rregullore, në rastet e shkeljes së tyre, për të garantuar zhvillimin normal të punës së tij.

10. Këshilli bën interpretimin e informacionit statistikor në një gjuhë të kuptueshme dhe në formë të përshtatshme për t'ua shpërndarë medias dhe publikut.

11. Këshilli monitoron perceptimin e publikut për veprimtarinë e tij dhe të sistemit në prokurorisë në tërësi.

12. Anëtari i caktuar i raporton Këshillit mbi zbatimin e Strategjisë së Komunikimit.

Lidhja 1

FORMULAR AKREDITIMI PËR MEDIAN

Emri dhe mbiemri:

Media:

E-mail:

Numri i telefonit:

Nënshkrimi:

Formulari plotësohet nga përfaqësuesit e mediave për marrjen e lejes për të bërë regjistrime audiovizuale në sallën e mbledhjeve të Këshillit. Në rastet kur çmohet nga Këshilltari për median, i caktuar për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun, mund të shmanget nënshkrimi i formularit.

Bashkëlidhur këtij formulari duhet të jetë një kopje e dokumentit që provon identitetin, i cili duhet të përmbajë një fotografi, në të cilën përfaqësuesi i medias është qartësisht i dallueshëm.

Përveç interesit për informim të publikut, Këshilli ka detyrimin ligjor të sigurojë edhe të drejtën e privatësisë për personat e përfshirë gjatë shqyrtimit të çështjeve të ndryshme në seancë plenare, të cilët janë të pranishëm ose jo, si dhe emrat në dokumente procedurale, të cilët duhet të mbrohen dhe të mos cenohen.

Mediat duhet të sigurojnë që privatësia e të gjithë personave të përfshirë në mbledhjen plenare do të respektohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Këshilli rezervon të drejtën për të përjashtuar nga përdorimi i lehtësirave për mediat, në rast se do të shkelen rregullat e përcaktuara në rregulloren përkatëse.

Vendimet e Këshillit janë të aksesueshme për publikun në faqen zyrtare të internetit.

Regjistrimi audio i mbledhjes plenare bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit. Përpara publikimit, administrata kujdeset për redaktimin e materialit, duke fshirë çdo referencë tek emrat konkretë, përveç emrave të anëtarëve të Këshillit dhe emrave të prokurorëve, ndaj të cilëve janë vendosur masa disiplinore, përveç masës disiplinore të shkarkimit.

Procesverbali me përmbledhjen e diskutimeve bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi miratohet nga mbledhja plenare pasardhëse. Edhe në këtë rast, administrata kujdeset për të fshirë çdo referencë tek emrat konkretë, përveç emrave të anëtarëve të Këshillit dhe emrave të prokurorëve, ndaj të cilëve janë vendosur masa disiplinore, përveç masës disiplinore të shkarkimit.